


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Shkurt 2024

**Tiranë, më 18 Mars 2024:** Në Shkurt 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 32 mld lekë, duke u ulur me -16,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 7,9 %, në krahasim me Janar 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 74 mld lekë, duke u rritur me 6,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 22,8 %, në krahasim me Janar 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u rritur me 34,0 %, krahasuar me Shkurt 2023 dhe me 37,3 %, në krahasim me Janar 2024.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dymujor eksportet e mallrave arritën vlerën 62 mld lekë, duke u ulur me -23,0 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 134 mld lekë, duke u rritur me 5,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 72 mld lekë, duke u rritur me 52,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shkurt 2024, në uljen e eksporteve prej -16,1 %, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -7,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,5 pikë përqindje, Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,3 pikë përqindje etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,1 pikë përqindje.

Për publikim 18/03/2024

**Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2024**




Eksportet, gjatë këtij dymujori janë ulur me -23,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -13,9 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,1 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,1 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Shkurt 2024, në rritjen e importeve prej 6,4 %, krahasuar me Shkurt 2023, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +7,4 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,6 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,8 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -1,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,5 pikë përqindje.

**Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2024**



Si dymujor, importet janë rritur me 5,0 %, krahasuar me dymujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +6,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,0 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,5 pikë përqindje, etj.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Shkurt 2024, vendi me të cilin Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2023 është: Kosova (21,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-16,2 %), Greqia (-41.6 %) dhe Gjermania (-5.1 %).

Gjatë këtij dymujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (-12,1 %), Turqia (-9,3 %) dhe Kina (-29,2 %).

Në muajin Shkurt 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Turqia (61,4 %), Gjermania (12,5 %) dhe Greqia (29,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-8,9 %), Kina (-27,9 %) dhe Maqedonia (-16,6 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (30,4 %), Greqia (32,7 %) dhe Gjermania (12,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-4,1 %), Kina (-15,3 %) dhe Maqedonia (-11,8 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 57,7 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,1 %), Turqia (12,0 %), Gjermania (7,3 %) dhe Greqia (7,2 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 58,1 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 49,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,8 %), Turqia (10,0 %), Greqia (7,4 %) dhe Gjermania (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shkurt 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	Janar - Shkurt 21	49	1,0	98	4,3	-49	49,7
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	Janar - Shkurt 22	72	49,0	124	26,7	-51	58,4
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	Janar - Shkurt 23	80	11,2	128	3,2	-47	63,0
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	Janar - Shkurt 24	62	-23,0	134	5,0	-72	46,2

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shkurt 2023**

	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Janar - Shkurt 2023	Janar - Shkurt 2024	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Janar - Shkurt 2023	Janar - Shkurt 2024
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>29.483</b>	<b>23.782</b>	<b>58.452</b>	<b>46.960</b>	<b>36.780</b>	<b>37.447</b>	<b>65.250</b>	<b>66.862</b>
Austri	542	210	756	462	556	748	968	1.288
Gjermani	2.183	2.072	5.247	4.074	5.066	5.698	8.897	10.015
Greqi	3.556	2.077	6.905	3.940	4.256	5.513	7.943	10.539
Itali	17.339	14.533	33.087	29.086	16.743	15.252	28.593	27.418
Spanjë	1.110	1.091	3.227	2.064	984	798	1.947	1.604
Kroaci	638	380	1.014	979	523	306	986	495
Të tjera të BE-së	4.115	3.420	8.215	6.355	8.653	9.132	15.914	15.502
Mbretëri e Bashkuar	149	139	326	242	868	726	1.336	1.211
Kinë	754	650	1.313	930	8.032	5.792	13.836	11.715
Kosovë	2.690	3.259	6.292	6.138	766	948	1.812	1.660
Maqedonia e Veriut	1.490	1.223	5.932	1.969	1.128	941	1.947	1.717
Rusi	-	-	3	-	492	320	943	393
SHBA	423	362	906	749	1.245	1.459	2.568	4.311
Turqi	325	281	895	812	7.734	12.484	14.406	18.781
Ukrainë	206	104	342	114	191	288	537	876
Zvicër	545	169	1.611	247	663	730	1.205	1.091
Të tjera	2.271	2.189	4.342	3.792	11.583	12.769	23.843	25.484
<b>Gjithsej</b>	<b>38.336</b>	<b>32.159</b>	<b>80.414</b>	<b>61.952</b>	<b>69.482</b>	<b>73.904</b>	<b>127.680</b>	<b>134.100</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Shkurt 2024**

Grup-mallrat	Eksporte		Importe					
	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Janar - Shkurt 2023	Janar - Shkurt 2024	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Janar - Shkurt 2023	Janar - Shkurt 2024
<b>Gjithsej</b>	<b>38.336</b>	<b>32.159</b>	<b>80.414</b>	<b>61.952</b>	<b>69.482</b>	<b>73.904</b>	<b>127.680</b>	<b>134.100</b>
Ushqime. pije. duhan	3.737	3.794	7.315	7.414	10.170	11.277	19.961	21.193
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	8.960	5.998	22.830	11.646	7.266	6.411	15.372	12.768
Produkte kimike dhe plastike	1.133	1.279	2.145	2.437	9.895	10.442	17.049	17.607
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	307	230	569	406	1.308	1.083	2.260	1.864
Prodhime druri dhe letre	990	830	1.985	1.617	2.602	2.601	4.367	4.314
Tekstile dhe këpucë	11.094	9.353	22.449	18.596	8.007	6.678	14.401	12.487
Materiale ndërtimi dhe metale	7.428	6.549	14.498	12.032	9.507	9.155	18.576	19.907
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	3.740	3.294	6.876	6.185	17.741	22.908	30.336	38.211
Të tjera	946	833	1.747	1.619	2.987	3.349	5.358	5.747

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2024**

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>33.087</b>	<b>29.086</b>	<b>6.292</b>	<b>6.138</b>	<b>5.247</b>	<b>4.074</b>	<b>6.905</b>	<b>3.940</b>
Ushqim. pije duhan	2.304	2.521	756	750	336	300	725	693
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.380	2.008	1.820	1.795	2.666	1.511	3.821	492
Produkte kimike dhe plastike	1.021	1.052	461	520	9	3	157	138
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	543	348	1	1	2	0	8	44
Prodhime druri dhe letre	1.241	906	167	208	26	22	286	247
Tekstile dhe këpucë	17.650	13.961	27	32	1.530	1.629	1.055	1.434
Materiale ndërtimi dhe metale	4.665	4.069	2.582	2.388	195	114	725	725
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	3.392	3.331	259	237	410	437	8	36
Të tjera	890	891	219	207	73	59	119	131

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2024**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>11.849</b>	<b>27.418</b>	<b>14.406</b>	<b>18.781</b>	<b>13.836</b>	<b>11.715</b>	<b>7.943</b>	<b>10.539</b>
Ushqim. pije duhan	3.936	4.400	826	864	257	341	2.536	2.793
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	619	230	2.376	1.601	5	3	675	1.717
Produkte kimike dhe plastike	3.423	3.566	1.951	1.896	1.210	982	1.356	2.021
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.800	1.457	55	51	121	141	6	42
Prodhime druri dhe letre	1.031	874	987	722	244	243	499	552
Tekstile dhe këpucë	6.887	5.369	2.132	1.703	1.854	2.018	801	1.049
Materiale ndërtimi dhe metale	4.047	3.368	3.619	4.565	1.935	1.503	1.240	1.388
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	5.723	6.729	1.790	6.730	7.200	5.388	480	513
Të tjera	1.127	1.425	669	650	1.010	1.095	350	464



# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës, Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv,

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues,

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore,

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri